Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se në mesin e Anëtarëve të përzgjedhur të Bordit të Përkohshëm Menaxhues të NSH Inex Sharr Brezovicë me mandat një vjeçar nga data 29 Qershor 2023 deri me datë 28 Qershor 2024 është edhe Z. Shukri Gashi. Z. Gashi nga data 05 shkurt 2024 ka filluar punën në Trepça SHA – Mitrovicë si Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit, ku përveç që është edhe vlerësues i pronave të paluajtshme në të njëjtën kohë është edhe anëtar i Bordit të Përkohshëm Menaxhues të NSH Inex Sharr Brezovicë. Z. Gashi me qëllim të shmangies të konfliktit të interesit ka kërkuar interpretim nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me funksionet që ushtron kryesisht në institucionet publike, ku Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit me datë 14.03.2024 kishe lëshuar vendim për të. Prandaj duke u bazuar nga Vendimi për rastin APK-DPKI-06-0208/24 të datës me nr.prot. 467/24 të datës 15.03.2024, z. Gashi nga data 05 shkurt 2024 nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të. Nga dëshmitë e siguruara nga Menaxhmenti i NSh Inex Sharr Brezovicë pagesat e rregullta janë realizuar nga Korriku 2023 deri në Shkurt 2024, dhe i njëjti nga kjo periudhë nuk është kompensuar për pjesëmarrje në takimet e rregullta të Bordit të Përkohshëm të NSH Inex Sharr Brezovicë Menaxhmenti i Agjencisë ka propozuar që të bëhet pagesa për pjesëmarrje në mbledhje të rregullta sipas dëshmisë së prezencës fizike për periudhën nga muaji Mars 2024 deri në përfundim të mandatit të Bordit të përkohshëm Menaxhues të NSH Inex Sharr Brezovicë me datë 28.06.2024, duke u bazuar në Nenin 9 paragrafi i 2.4 të Ligjit nr. 05/L-028 për tatim në të ardhura personale. Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 qershor 2024

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-204/66

Në bazë të Neneve6.1.1; 6.1.2 dhe 15.2.4 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 2 dhe 3 të Rregullores nr. 05-2022 për përgjegjësitë e Bordit dhe Drejtorit menaxhues të NSH Inex Sharr Planona Brezovicë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 qershor 2024 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Aprovohet vazhdimi i mandatit të Bordit të përkohshëm të NSH Inex Sharr Planina Brezovicë për periudhë 1 (një vjeçare) duke filluar nga data e emërimit.**

**II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

**ARSYETIM**

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Menaxhmenti për lidhur me mandatin e Bordit të përkohshëm të NSh Inex Sharr Brezovicë GJI092.

Ky vendim u aprovuar duke u bazuar në faktin se Bordi me 29 qershor 2023 përmes vendimit me nr. ref. BD-183/27 ka emëruar anëtarët e Bordit të Përkohshëm të Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina Brezovicë. Mandati i Bordit të Përkohshëm të Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina Brezovicë ka qenë një vit duke filluar nga data e emërimit. Përzgjedhja e Bordit të Përkohshëm të Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina Brezovicë është bërë përmes procedurës konkurruese përmes shpalljes së konkursit publik.

Për shkak të rëndësisë së zhvillimit të aktivitetit të ndërmarrjes pa pengesa si dhe për shkak që kjo NSh ka Ushtrues të Detyrës së Drejtorit dhe në mënyrë që mos të ketë pengesa në ecurinë e punëve të NSH-së rreth përgatitjes për sezonin të ardhshëm dimëror, paraqitet nevoja që kjo NSh të vazhdoj të ketë Bord të Përkohshëm.

Duke u bazuar në atë që u cek më lartë dhe në mënyrë që të ketë një mbarëvajtje të procesit dhe punës në NSH Inex Sharr Planina Brezovicë, si dhe bazuar në nenin 3 të Rregullores nr. 05-2022 për përgjegjësitë e Bordit dhe Drejtorit menaxhues të NSH Inex Sharr Planina Brezovicë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 qershor 2024.

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-204/67

Në bazë të Neneve 6.1.1; 6.1.2 dhe 15.2.4 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 qershor 2024 nxjerr këtë:

# V E N D I M

**I. Aprovohet propozimi i Menaxhmentit të AKP-së, lidhur me plotësimin e Bordit të Përkohshëm Menaxhues të PEJ116 Ndërmarrjes Shoqërore "Jatex" edhe me dy anëtarë të ri;:**

**i. Klementina Zeka-Anëtare e Bordit (Magjistër e shkencave Ekonomike, Banka Financa dhe Kontabilitet) me efekt nga data 16 nëntor 2024 dhe**

**ii. Manjolla Bejtullahu-Anëtare e Bordit (Bachelor Menaxhment dhe Informatikë) me efekt nga data 01 korrik 2024.**

**II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Menaxhmenti për lidhur me mandatin e dy anëtareve të Bordit të përkohshëm të PEJ116 Ndërmarrjes Shoqërore "Jatex.

Ky vendim u aprovuar duke u bazuar në faktin se Bordi me Anëtari i Bordit të Përkohshëm Menaxhues z. Zeki Dobroshi me datë 20.05.2020 ka mbushur 65 vjet, dhe meqë ka arrit moshën e pensionimit nga kjo datë Bordi i Përkohshëm Meanxhues ka qenë në përbërje prej vetëm dy anëtarëve. Gjithashtu anëtarja tjetër e Bordit të Përkohshëm Menaxhues të Ndërmarrjes "Jatex" znj. Kujtesa Hasi e cila me datë 30 qershor 2024 mbush 65 vjet, pra arrin moshën e pensionimit dhe nga kjo datë, Bordi i Përkohshëm i NSH Jatex do të mbetet vetëm me Kryetar të Bordit, z. Naser Bordoniqi. Me datë 10 qershor 2024, Bordi i Përkohshëm Menaxhues i Ndërmarrjes "Jatex" ka propozuar dy anëtarët sipas dispozitivit të këtij vendimi. Anëtarët e propozuar dhe anëtari/kryetari aktual i Bordit të Përkohshëm Menaxhues të Ndërmarrjes "Jatex" janë punëtorë të Ndërmarrjes të cilët paguhen nga të hyrat e Ndërmarrjes dhe në këtë kuptim plotësimi i Bordit prej tre anëtarëve nuk do të shkaktoj shpenzime shtesë për buxhetin e Ndërmarrjes, po ashtu të njëjtit janë me kualifikim të lartë.

Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 qershor 2024.

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-204/68

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247 dhe me Ligjin Nr. 8/L-011, Ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86), Politika Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Udhëzuesi për parashtrimin e kërkesës për blerjen e banesës për të cilin ekziston e drejta banesore, i aprovuar nga Menaxhmenti - Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 qershor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet Ndryshimi i Vendimit të Bordit të Drejtorëve Ref. Nr. BD-1664/41 i datës 04.07.2022, në vend të palës , zëvendësohet me palën**
**II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të vazhdoj tutje me përmbylljen e kërkesës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH Agrokosova – Komerc" Fushë Kosovë.**
**III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Menaxhmenti për ndryshimin e vendimit të Bordi 1664-41, dt. 04.07.2022 nga pala , në

Ky vendim u aprovuar duke u bazuar në faktin se me 17.06. 2022, Komisioni për Banesa ka propozuar te Bordi i Drejtorëve, që ta aprovoj Raportin e Komisionit me rekomandim për 13 kërkesa në Raportin e datës 10.06.2022, përfshirë edhe kërkesa KB- 1305/15, e parashtruar me 14.04.2015, në emër të në cilësi të bartësit të së drejtës banesore. Me datë 04.07.2022, Bordi miratoi Raportin me rekomandime te Komisionit për Banesa datës 10.06.2022 me Ref. Nr. BD-1664/41. Komisioni me date 19.07.2022, e njoftoi Kompaninë "AL Petroll" ku pala ishte pronar, në pamundësi të sigurimit të kontaktit me familjarët. Familjarët e të ndjerit kanë reflektuar me sjelljen e faturës si dëshmi për realizimin e pagesës në bankën TEB, për te cilën Komisioni ka bërë verifikimin për realizimin e pagesës. Komisioni është informuar nga , bashkëshortja e bartësit të së drejtës banesore , se bashkëshorti i saj . kishte ndërruar jetë me date 21.07.2020. Komisioni paraprak ka vazhduar procedimin e përmbylljes se kontratës për kërkesën në fjalë mirëpo z. , përmes familjareve e ka njoftuar Komisionin se për arsye shëndetësore nuk ka pasur mundësi të vijë ne Komision për ta nënshkruar kontratën. Me datë 15.03.2023, z. ka sjellë dokumentet shtesë si: Certifikatën e vdekjes V 10515924 të datës 15.07.2022 për Certifikatën e martesës M 11023503, dhe Extraktin nga regjistri Qëndror i Gjendjes Civile E 26318184 në emër të . Komisioni paraprak përsëri e ka kontaktuar palën për vazhdim te procedurës së përmbylljes Kontratës, por z. kishte pasur rast vdekje në familje të ngushte dhe nuk ishte në gjendje për të vazhduar procesin e përmbylljes kontratës. Me datë 22.04.2024, pala ka kontaktuar Komisionin dhe ka kërkuar mirëkuptim për vonesë lidhur me vazhdimin e procesit të përmbylljes Kontratës. Duke u bazuar në gjendjen faktike Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 27 qershor 2024.

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Nr. Ref. BD-204/69

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 qershor 2024 nxjerr këtë:

## VENDIM

**I. Shfuqizohet vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së nr. Ref. BD-55/5 i datës 18.07.2013.**

**II. Anulohet shitja për Njësinë 12 në SHAL 20: "Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore Miradi e Poshtme I" me sipërfaqe totale prej 19099 m2 (1 ha 90 ari 99 m2) me çmimin 211 €/ari dhe çmimin e përgjithshëm 40,299 € për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe juridike.**

**III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e vazhdimit të procedurave të shitjes dhe përmbylljes së kontratës për Njësinë 12 në Shitjen e Aseteve 20: "Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore Miradi e Poshtme I". Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aseti në kompetencat administrative të Agjencisë.

Njësia 12 në SHAL 20 "Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore Miradi e Poshtme I" është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së për shitje me çmimin e ofertës 72,800 € me blerës z. Xhafer Plakiqi dhe me sipërfaqen 34504 m2 (3 ha 45 ari 04 m2). Çmimi i ofruar korrespondonte me 21,099 €/ha apo 211 €/ari. Me datë, 02 tetor 2013, AKP informohet lidhur me Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme C-IV-13-0928, me të cilin AKP-së i ndalohet të ndërmarr çfarëdo veprimi lidhur me shitjen e një pjese të Njësisë 12 në SHAL 20, lidhur me parcelën P-72514027-00293-0 ZK Miradi e Poshtme – Fushë Kosovë me sipërfaqe 15405 m2 (1 hektarë 54 ari 05 m2). AKP kishte ndërmarr të gjitha veprimet lidhur me respektimin e vendimit të cituar si më sipër dhe kishte pezulluar procesin e dorëzimit të kontratës për shitjen dhe bartjen e pronës deri në një vendim tjetër të gjykatës dhe poashtu kishte njoftuar blerësin e përkohshëm z. Xhafer Plakiqi. Blerësi i përkohshëm për Njësinë 12 në SHAL 40: "Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore Miradi e Poshtme I" z. Xhafer Plakiqi me datën 05 prill 2024, ka dërguar shkresë në AKP dhe ka kërkuar që të vazhdojë procesin e blerjes vetëm për parcelat që nuk kanë Masë Ndalese. Ndërsa për parcelën P-72514027-00293-0 që ka qenë pjesë e kësaj shitjeve poashtu ka ndryshim rrethanash duke qenë se kjo parcelë ka kaluar në emër të personave privat si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës komunale.

Pas trajtimit ligjor, dhe duke marr parasysh se sipërfaqja e asetit ka ndryshuar, duke marr parasysh që çmimi i ofruar në vitin 2013 konsiderohet i ulët me kohën e sotme kur u parashtrua çështja për përmbyllje dhe duke marr parasysh që u konsiderua se potencialisht dëmtohen kreditorët, duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:**
Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 qershor 2024.

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-204/70

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 qershor 2024 nxjerr këtë:

## VENDIM

**I. Shfuqizohet Vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së të datës 30 shtator dhe 01 tetor 2009 për aprovimin e shitjes për Ndërmarrjen e Re "AgroKosova Zyret SH.P.K", për shkak të ndryshimit të situatës apo rrethanave faktike ose ligjore dhe ky aset ritenderohet në fazat e mëvonshme në shitjet e likuidimit.**

**II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për trajtimin e çështjes se Ndërmarrjes se Re "AgroKosova Zyret SH.P.K".

Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aseti në kompetencat administrative të Agjencisë.

Ndërmarrja e Re "AgroKosova Zyret Sh.P.K." është tenderuar në valën e 37 të Privatizimit respektivisht me 12 gusht 2009, me të dhënat e detajuara si në Memorandumin e Informimit (IM), me sipërfaqen e lokalit prej 267.64 m2. Në këtë proces ofertimi kanë marr pjesë 6 ofertues, ku ofertuesi me çmimin me të lartë është shpallur ofertuesi me shifrën , me çmimin e ofruar prej 321,111 €, apo 1,200 €/m2. Çmimi me i lartë është miratuar nga Bordit me datë, 30 shtator 2009. Me datë, 05 nëntor 2009, AKP informohet lidhur me Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme SCC-09-0151, datë 27.10.2009, me të cilin AKP-së i ndalohet të ndërmarr çfarëdo veprimi lidhur me privatizimin e Ndërmarrjes së Re "AgroKosova Zyret Sh.P.K" e tenderuar në valën e 37 të Privatizimit. AKP kishte ndërmarr të gjitha veprimet lidhur me respektimin e vendimit të cituar si më sipër dhe kishte pezulluar procesin e dorëzimit të kontratës për shitjen dhe bartjen e pronës deri në një vendim tjetër të gjykatës.

Me 01 mars 2016, AKP është informuar lidhur me Aktgjykimin tjetër të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme SCC-09-0151, datë, 19.02.2016, me të cilin gjykata e refuzon padinë e paditësit si të pa bazuar. Ndërkaq, me 24 tetor 2019, AKP informohet me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit AC-I.-16-0054, datë, 19.09.2019, me të cilin refuzohen ankesat dhe vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë SCC-09-0151, datë, 19.02.2016, me të cilin gjykata e refuzon padinë e paditësit si të pa bazuar.

Arsyet e vonesave për adresimin e kësaj çështje janë trajtuar nga Zyrtari për Standarde Profesionale dhe pas nxjerrjes së konkluzioneve nga ky i fundit, tanimë nuk ka pengesa të vazhdohet tutje për trajtim.

Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligji Nr. 06/L-086), neni 9, paragrafi 14, specifikon se "Të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e kolegjit të apelit janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër". Poashtu ish bleresi i përkohshëm nuk figuron më si biznes aktiv dhe nuk ka ardhur asnjëherë për tu interesuar lidhur me shitjen.

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Pas trajtimit ligjor, bazuar në çmimin orientues, në opinionin ligjor të Departamentit Ligjor të AKP-së dhe në faktin se blerësi i përkohshëm është subjekt pasiv në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë rekomandohet dhe duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:**
Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 qershor 2024.

**Mentor Hysqni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-204/71

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullore Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Udhëzuesi për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 qershor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohen rekomandimet e Menaxhmentit sipas rezultateve të qiradhënies përmes shpalljes publike të datës 07.06.2024, sipas listës së bashkangjitur të rishikuar.**

**II. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin nga Menaxhmenti për shqyrtimin e rezultateve/çmimeve të ofertimit nga qiradhënia e aseteve përmes shpalljes publike sipas rezultateve të datës 07.06.2024.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore pa marrë parasysh a janë vendosur ndërmarrjet në likuidim apo jo me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së.
Prandaj, dhënia eventuale me qira e aseteve në shtojcë do ti shërbente rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), fonde këto që do të mbahen në mirëbesim për të paguar shpenzimet e likuidimit, pagesat për kreditorëve dhe transferohen eventualisht në Buxhetin e Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë/indirekt i të hyrave nga inkasimi i qirave.
Kontratat e qirasë për asetet e ndërmarrjeve në likuidim nënshkruhen nga Kryesuesit e Autoriteteve të Likuidimit sipas autorizimeve të parapara në Shtojcën e ligjit të AKP-së.
Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 qershor 2024

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## Lista e Aseteve për qiradhënie të Aseteve të NSH-ve në Likuidim përmes shpalljes publike e dates 07 qershor 2024

| Nr | Rajoni | Emri i NSH-së-njësia | Emri i Ofertuesit me ofertën më të lartë | Lloji i asetit | Qiradhenie Mujore/Vjetore | Vendndodhja e Asetit dhe Komuna | Nr i vendimit të DM mbi themelimin e Komisionit për qira | Sa herë është dhënë me qira? | Cmimi më i lartë i qiradhënies paraprake ose Tenderimit te fundit | Sipërfaqja m² | Cmimi krahasues në bazë të krahasimeve e në Raportet e Vlerësimi per m2 | Cmimi krahasues në bazë të krahasimeve e në Raportet e Vlerësimi per ari | Cmimi i ofertës më të lartë të pranuar m2 | Cmimi i ofertës më të lartë të pranuar ari | Cmimi i Ofertës më të lartë | Numri i Ofertave | Venimi i Bordit | A ka të angazhuar momenalisht sigurim për asetin PO/JO | Shuma mujore e pageses se Sigurimit te asetit | Koment / Verejtaje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 31 | Prizreni | PRZ011 NSH NBI Rahoveci, Rahovec | Habib Dina | Prona në Hoqë të Vogël 2 | Qiradhënie Vjetore | Ofrohen për qiradhënie 3 ngastra në ZK Hoqë e Vogël, Rahovec me numër të ngastrave kadastrale: | DE 278/2024 | | | 14,598 | | € 4.27 | | € 0.72 | € 105 | 1 | Aprovim | JO | | Edhe pse Komisioni ka rekomanduar refuzimin e ofertës për këtë njësi, DE ka marr për bazë çmimin mesatar ne Komunën e Gjakovës meqë ZK me tepër i përafrohen krahasimit te çmimit me Komunën e e Gjakovës ku çmimi mesatar ne baze te kontratave aktuale është 0.66 euro për ari dhe kjo mesatare korrespondon me shumicën e pronave bujqësore të natyrës së njëjtës në nivel të Kosovës. Krahasimi që është marr nga Komisioni është marr për toka që nuk janë afër tokave të tenderuar meqë nuk kanë patur qira të mëhershme në këtë Zonë Kadastrale apo në afërsi të saj. Çmimi krahasues që është marr nga Komisioni devijon nga mesatarja në nivel të Kosovës dhe sqarimi më i detajuar lidhur me këtë do të ipet në mbledhje te BID. |
| 32 | Prizreni | PRZ011 NSH NBI Rahoveci, Rahovec | Afrim Morina | Prona në Ratkoc 2 | Qiradhënie Vjetore | Ofrohen për qiradhënie 15 ngastra në ZK Ratkoc, Rahovec me numër të ngastrave kadastrale: | DE 278/2024 | | | 37,507 | | € 4.27 | | € 0.53 | € 200 | 1 | Refuzim | JO | | |
| 33 | Prizreni | PRZ011 NSH NBI Rahoveci, Rahovec | Afrim Morina | Prona në Ratkoc 4 | Qiradhënie Vjetore | Ofrohen për qiradhënie 21 ngastra në ZK Ratkoc, Rahovec me numër të ngastrave kadastrale: | DE 278/2024 | | | 38,211 | | € 4.27 | | € 0.52 | € 200 | 1 | Refuzim | JO | | |
| 34 | Prizreni | PRZ009 NSH DLB Lavërtari-Blegtori, Prizren | Andi Binaj | Toke Bujqesore në Atmaxhë 2 | Qiradhënie Vjetore | Ofrohen për qiradhënie 4 ngastra në ZK Atmaxhë, Prizren me numër të ngastrave kadastrale: P-71813001-00635-0 me sipërfaqe prej 2086m² | DE 277/2024 | 1 | 350 | 27,562 | | € 4.27 | | € 0.54 | € 150 | 1 | Refuzim | JO | | |

MA.

## Lista e Aseteve për qiradhënie të Aseteve të NSH-ve në Likuidim përmes shpalljes publike e dates 07 qershor 2024

| Nr | Rajoni | Emri i NSH-së-njësia | Emri i Ofertuesit me ofertën më të lartë | Lloji i asetit | Qiradhenie Mujore/Vjetore | Vendndodhja e Asetit dhe Komuna | Nr i vendimit të DM mbi themelimin e Komisionit për qira | Sa herë është dhënë me qira? | Cmimi më i lartë i qiradhënies paraprake ose Tenderimit te fundit | Sipërfaqja m² | Cmimi krahasues në bazë të krahasimeve e në Raportet e Vlerësimi per m2 | Cmimi krahasues në bazë të krahasimeve e në Raportet e Vlerësimi per ari | Cmimi i ofertës më të lartë të pranuar m2 | Cmimi i ofertës më të lartë të pranuar ari | Cmimi i Ofertës më të lartë | Numri i Ofertave | Venimi i Bordit | A ka të angazhuar momenalisht sigurim për asetin PO/JO | Shuma mujore e pageses se Sigurimit te asetit | Koment / Verejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 52 | Prishtinë | KB Kosova | Kastriot Dermaku | Tokë komerciale | Qiradhënie Mujore | ZK Gushterice e Ulte, Graçanice | DE260/2024 | - | - | 3,800 | € 17.95 | | € 26.29 | | € 999 | 4 | Aprovim | JO | - | Per kete njesi kemi pranuar 2 oferta me qmim te njejte prej 999 euro. Dhe ne baze te shpalljes ofertusi I cili dorezon oferten ne kohe me heret athere ka perparesi. |
| 53 | Prishtinë | Ramiz Sadiku | Pite RKS L.L.C | objekt | Qiradhënie Mujore | Lagja Pejton, Rr. Jonuz Zejnullahu Prishtinë | DE261/2024 | - | - | 346m2 objekt 637m2 oborr | € 6.98 | € 10.12 | | | € 3,500 | 3 | Aprovim | JO | - | |
| 54 | Prishtinë | NSh ABC Genci | Railmont sh.p.k. | Objekt | Qiradhënie Mujore | Rr.Rexhep Luci, Prishtine | DE 255/2024 | 1 | € 3,700.00 | 346 | € 8.17 | € 10.98 | | | € 3,800 | 1 | Aprovim | PO | € 530 | |
| 55 | Prishtinë | Auto Moto Kosova | Armend Krasniqi | Tokë komerciale | Qiradhenie Mujore | Lagja Emshir - Pjese e siperfaqes se ngastres 7584-2 dhe 7581-2, 11000 | DE258/2024 | 1 | € 10,100.00 | 11,000 | € 0.44 | € 5.01 | | | € 55,100 | 8 | Aprovim | JO | | |
| 56 | Mitrovica | NSHBQ Drenica, Njesia 8. Tokë bujqësore pjesë e parcelës nr. 00032-0 | Fidan Doberdolani | bujqësore | Qiradhënie Vjetore | ZK Korroticë e Epërme, Drenas/Gllogoc | DE 245-2024 | 1 | € 0.00 | 13,000 | | € 0.71 | | € 2.31 | € 300 | 4 | Aprovim | Jo | | |
| 57 | Mitrovica | NSHBQ Drenica, Njesia 9, parcela nr. 00249-2 | Fidan Doberdolani | bujqesore | Qiradhenie Mujore | ZK Korroticë e Epërme, Drenas/Gllogoc | DE 245-2024 | 0 | € 0.00 | 1,494 | € 0.12 | | € 0.13 | | € 200 | 7 | Aprovim | Jo | | |
| 58 | Mitrovica | NSHB Elan-Prona bujqesore Vushtrri parcela nr. 01431-0. Njesia 10. | Hamit Sejdiu | Tokë Bujqesore | Qiradhenie Vjetore | Rr. Arsim Tahiri, Vushtrri | DE 246-2024 | 1 | € 200.00 | 16,747 | | € 1.87 | | € 1.79 | € 300 | 1 | Aprovim | Jo | N/A | Vetem nje kontrate eshte marr per krahasim. |
| 59 | Mitrovica | NSHB Elan-Prona komerciale ne Vushtrri pjese e parceles 02253-5 ), Njesia 11 | Halil Hasani | Tokë Komerciale | Qiradhenie Mujore | Rr. Deshmoret e Kombit, Vushtrri | DE 246-2024 | 1 | € 100.00 | 2,800 | | | € 0.11 | | € 300 | 1 | Aprovim | Jo | N/A | Nuk ka kontrate per krahasim ne kete zone. |
| 60 | Mitrovica | NSHB Elan-Prona bujqësore në parcela 0164-0, Njesia 12. | Fatmir Duraku | Tokë Bujqesore | Qiradhenie Vjetore | Fshati Gllavotin | DE 246-2024 | 0 | € 0.00 | 33,998 | | | | € 0.59 | € 200 | 1 | Aprovim | Jo | N/A | Nuk ka kontrate per krahasim ne kete zone. |
| 61 | Mitrovica | NSH Transkosova-Garazhi I automjeteve (vetem nje pjese e objektit jo edhe toka) | Haxhi Krasniqi | depo | Qiradhenie Mujore | Fshati Zhabarë i Ulet, Mitrovicë jugore | DM 242/2024 | 1 | € 0.00 | 1,000 | € 0.04 | | € 0.20 | | € 200 | 3 | Aprovim | Jo | N/A | |

M.H.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-204/72

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores nr. 7/2023 për qiradhënie të aseteve të NSh-ve, Neni 2.5 i Kontratave të Qirasë të nënshkruara në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSh "Tregu" dhe parashtruesve të kërkesave, nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 qershor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratave të qirasë tek NSh Tregu:
   a) Nga Fatmir Ismajli si qiramarrës i pjesës së tokës afariste në të cilin është vendosur tezga nr. 1 në sipërfaqe prej 2 m2, e cila ndodhet në Tregun në Ulpianë tek Altin Ismajli në shumën prej 50.00 Euro/muaj;
   b) Nga NTP EBF përfaqësuar nga Enis Krasniqi si qiramarrës i pjesës së tokës afariste e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët tek Selatin Haliti në shumën prej 150.00 Euro/muaj;
   c) Nga Florim Podvorica si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 48 me sipërfaqe prej 90 m2, e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët tek Menard Mulliqi në shumën prej 270.00 Euro/muaj;
   d) Nga "Modesa" Sh.P.K përfaqësuar nga Nysret Bajrami, si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 92 në sipërfaqe prej 100 m2 e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët tek "Uka Home" Sh.P.K përfaqësuar nga Enver Uka në shumën 300.00 Euro/muaj;
   e) Nga Bedri Muçiçi si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 2/A në sipërfaqe prej 112 m2 e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët tek Agani Sh.P.K. në shumën prej 246.40 Euro/muaj;
   f) Nga Faton Bilalli si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 9/B në sipërfaqe prej 28 m2 e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët tek Fatoni Fashion Sh.P.K. përfaqësuar nga Faton Bilalli në shumën prej 80.00 Euro/muaj;
   g) Nga N.T.P Medi-Toni si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 2/B e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët tek Medi&Toni Sh.P.K. në shumën prej 150.00 Euro/muaj;
   h) Nga D.P.T. Alton si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 178 me sipërfaqe prej 53 m2 e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët tek Alton Shop Sh.P.K. në shumën prej 160.00 Euro/muaj;
   i) Nga Dilvin by Dugi Sh.P.K. si qiramarrës i pjesës së hapësirave afariste nr. 696; 697 dhe 732 (2A) e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët tek Duriqi Textil Sh.P.K. përfaqësuar nga Halit Duriqi në shumën prej 120.00 Euro/muaj.

II. Para lidhjes së aneks kontratave të qirasë të transferuara tek personat e lartëcekur, Qiramarrësit aktual do të jenë të obliguar të paguajnë borxhin e papaguar, ose në të kundërtën do të ndërmerren të gjitha veprimet ligjore për inkasimin e borxhit të papaguar dhe lirimin e hapësirave:
   a) Altin Ismajli si i biri i të ndjerit Fatmir Ismajli (ish qiramarrës) i pjesës së tokës afariste në të cilën është vendosur tezga nr. 1 tek Tregu në Ulpianë para bartjes së kontratës së qirasë tek Altin Ismajli është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 1.45 Euro;
   b) NTP EBF përfaqësuar nga Enis Krasniqi si qiramarrës i pjesës së tokës afariste e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët para bartjes së kontratës së qirasë tek Selatin Haliti është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 1,246.49 Euro;



MH

c) Florim Podvorica si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 48 e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët para bartjes së kontratës së qirasë tek Menard Mulliqi është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 2,242.27 Euro;
d) "Modesa" Sh.P.K përfaqësuar nga Nysret Bajrami nuk ka borxh të papaguar, andaj pas aprovimit të transferimit të kontratës së qirasë, kontrata do të nënshkruhet me "Uka Home" Sh.P.K përfaqësuar nga Enver Uka;
e) Bedri Muçiçi si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 2/A e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët para bartjes së kontratës së qirasë tek Agani Sh.P.K. është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 227.21 Euro;
f) Faton Bilalli si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 9/B cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët para bartjes tek Fatoni Fashion Sh.P.K. është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 295.59 Euro;
g) N.T.P Medi-Toni si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 2/B e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët para bartjes tek Medi&Toni Sh.P.K. është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 1,247.04 Euro;
h) Nga D.P.T. Alton si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 178 e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët para bartjes tek Alton Shop Sh.P.K. është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 147.80 Euro;
i) Dilvin by Dugi Sh.P.K. si qiramarrës i pjesës së hapësirave afariste nr. 696; 697 dhe 732 (2A) e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët para bartjes tek Duriqi Textil Sh.P.K përfaqësuar nga Halit Duriqi është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 221.70 Euro.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se NSh "Tregu" Prishtinë PRN104, është në proces të likuidimit që nga data 14 Korrik 2014. Kjo ndërmarrje ka vazhduar me aktivitetet e saj edhe gjatë procesit të likuidimit kryesisht në qiradhënie të hapësirave afariste.

Në këtë rast duhet kemi parasysh NSh Tregu është me karakter specifik dhe hapësirat e vendosura në tokën afariste janë të ndërtuara nga vetë qiramarrësit dhe të lejohet transferimi i kontratave të qirasë edhe pse në mes të qiramarrësit dhe personit që pranon transferimin e kontratës së qirasë nuk ka lidhje familjare dhe kemi parasysh se cedimi apo transferimi i këtyre kontratave të qirasë ju bëhet personave që ushtrojnë veprimtari të tregtisë. Poashtu, nuk është paraparë ndonjë kufizim për transferim të kontratave të qirasë, siç mund të jetë që transferimi i kontratave të qirasë të bëhet vetëm ndërmjet familjarëve ose partnerëve në një biznes, as në këto Kontrata të Qirasë, por si kusht kërkohet vetëm pëlqimi nga ana e AKP-së.

Më datë 13.06.2024, ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 24976/2024 e parashtruar nga pala Altin Ismajli që kontrata e qirasë për pjesën e tokës afariste në të cilën është vendosur tezga nr. 1 tek Tregu te Ulpiana të transferohet në emër të Altin Ismajli nga ish qiramarrësi Fatmir Ismajli (tanimë i ndjerë). Qiramarrësi Fatmir Ismajli ka hyrë në kontratë të qirasë më datë 04.09.2014 me kontratën me nr. protokolli 11444 për tokën afariste në të cilën është vendosur tezga nr. 1 tek Tregu në Ulpianë, në sipërfaqe prej 2 m2 në shumën prej 50.00 Euro/muaj. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është vetëm 1.45 Euro. Në këtë rast Altin Ismajli është i biri i Fatmir Ismajli (ish-qiramarrësi) tanimë i ndjerë.
Më datë 11.06.2024, ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 24958/2024 të parashtruar nga Enis Krasniqi përfaqësues i NTP EBF biznes individual për transferimin e kontratës së qirasë për hapësirën afariste



MA

nr. 71 tek Selatin Haliti. Enis Krasniqi ka hyrë në kontratë të qirasë më datë 18.06.2015 me kontratën me nr. protokolli 5391/2015 për hapësirën afariste nr. 71 tek Tregu tek ish-Amortizatorët për shumën prej 150.00 Euro/muaj. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës me nr. protokolli 50786/2023 të datës 28.12.2023.

ZR Prishtinë më datë 30.04.2024 ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 24721/2024 për transferim të kontratës së qirasë për hapësirën afariste nr. 48 nga Florim Podvorica tek Menard Mulliqi. Florim Podvorica ka hyrë në kontratë të qirasë më datë 02.11.2016 me kontratën me nr. protokolli 13842/2016 për hapësirën afariste nr. 48 tek Tregu te ish-Amortizatorët me sipërfaqe prej 90 m2 në shumën totale prej 270 Euro/muaj. Ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës më nr. protokolli 50935/2023 e datës 29.12.2023. Fillimisht kontrata në vitin 2016 ka qenë e lidhur në emër të Flori Commerce e përfaqësuar nga Florim Podvorica, kurse që nga data 01.11.2018 ka vazhduar vetëm në emër të Florim Podvorica.

ZR Prishtinë më datë 30.04.2024 ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 24720/2024 për transferimin e kontratës së qirasë për hapësirën afariste nr. 92 nga "Modesa" Sh.P.K me përfaqësues Nysret Bajrami tek "Uka Home" Sh.P.K. me përfaqësues Enver Uka. Modesa Sh.P.K. përfaqësuar nga Nysret Bajrami ka hyrë në kontratë të qirasë më datë 08.10.2015 në bazë të kontratës me nr. protokolli 8172/2015 për hapësirën afariste nr.34 tek Tregu te ish-Amortizatorët në sipërfaqe prej 100 m2 në shumën prej 300.00 Euro/muaj. Ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës me nr. protokolli 51069/2023 të datës 29.12.2023.
Modesa Sh.P.K. përfaqësuar nga Nysret Bajrami nuk ka borxh të papaguar.

ZR Prishtinë më datë 30.04.2024 ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 24719/2024 për transferim të kontratës së qirasë të hapësirës afariste nr. 2/A tek Tregu te ish- Amortizatorët nga Bedri Muçiçi tek Agani Sh.P.K. Bedri Muçiçi ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë më datë 18.09.2015 në bazë të kontratës me nr. protokolli 7906/2015 për hapësirën afariste nr. 2/A në sipërfaqe prej 112.00 m2 tek Tregu te ish-Amortizatorët në shumën prej 246.40 Euro/muaj. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës me nr. protokolli 50887/2023 të datës 29.12.2023.

ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 24755/2024 e datës 10.05.2024 për transferim të kontratës së qirasë për hapësirën afariste 9/B nga Faton Bilalli tek Fatoni Fashion Sh.P.K. me pronar Faton Bilalli. Faton Bilalli është pronar dhe përfaqësues i biznesit në të cilin do të kalojë kontrata e qirasë. Faton Bilalli ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë më datë 03.02.2015 me kontratën me nr. protokolli 964 për hapësirën afariste nr. 9/B tek Tregu te ish –Amortizatorët me sipërfaqe prej 28 m2 në shumën prej 80 Euro/muaj. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës me nr. protokolli 50928/2023 të datës 29.12.2023.

ZR Prishtinë më datë 10.05.2024 ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 24754/2024 për transferim të kontratës së qirasë për hapësirën afariste nr. 2/B nga N.T.P. Medi –Toni tek MEDI & Toni Sh.P.K. N.T.P. Medi – Toni me përfaqësues Bekim Rama kanë hyrë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë më datë 23.01.2015 me kontratën me nr. protokolli 348 për hapësirën afariste nr. 2/B tek Tregu te ish-Amortizatorët në shumën prej 150.00 Euro/muaj. Ka kontratë aktive të qirasë në bazë të ankes kontratës më nr. protokolli 50910/2023 të datës 29.12.2023. I njëjti do të jetë edhe përfaqësues i biznesit në emër të të cilit do të transferohet kontrata e qirasë, nëse aprovohet nga ana e Bordit të Drejtorëve.

Kërkesa me nr. protokolli 24753/2024 është pranuar më datë 10.05.2024 nga ZR Prishtinë për transferim të kontratës së qirasë për hapësirën afariste nr. 178 tek Tregu te ish-Amortizatorët nga D.P.T. Alton tek Alton Shop Sh.P.K. D.P.T. Alton përfaqësuar nga Sejdi Veliu ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë më datë 11.02.2016 në bazë të kontratës së qirasë me nr. protokolli 9856/2016 për hapësirën afariste nr. 178 tek Tregu te ish-Amortizatorët e cila ka sipërfaqe prej 53 m2 për shumën prej 160.00 Euro/muaj. Ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës së qirasë me nr. protokolli 50907/2023 e datës 29.12.2023.



MH

ZR Prishtinë ka pranuar më datë 20.06.2024 kërkesën me nr. protokolli 24992/2024 për transferim të kontratës së qirasë për hapësirat afariste nr. 696; 697 dhe 732 (2A) nga Dilvin by Dugi Sh.P.K. përfaqësuar nga Ardian Emiri tek Duriqi Textil Sh.P.K. përfaqësuar nga Halit Duriqi. Kërkesa fillimisht ishte paraqitur nga Halit Duriqi më datë 16.04.2024 por Autoriteti i Likuidimit ka kërkuar që kërkesa të paraqitet nga ana e vetë qiramarrësit sepse nuk mund të trajtohet kërkesa e palës e cila nuk ka kontratë të lidhur të qirasë. N.T.P. Dugi ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë më datë 28.01.2015 në bazë të kontratës së qirasë me nr. protokolli 632 për hapësirat afariste nr. 696; 697 dhe 732 (2A) në shumën prej 120.00 Euro/muaj. Ndërrimi i emrit në kontratë nga N.T.P. Dugi në Dilvin By Dugi Sh.P.K është bërë me aneks kontratën me nr. protokolli 22940/2018 të datës 12.03.2018.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do te mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm te fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 qershor 2024

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-204/79

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores nr. 7/2023 për qiradhënie të aseteve të NSh-ve, Neni 2.5 i Kontratave të Qirasë me nr. protokolli 39881/2022 në mes të "NewCo Grand Hotel", Prishtinë dhe Art Motion Sh.P.K; nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 qershor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratws të qirasë nga qiramarrësi aktual "Art Motion SH.P.K" tek "Bluechip International L.L.C" me emër tregtar "Comodita Home"për shfrytëzimin e zyra nr.2 në NewCO Grand Hotel PRN173, Prishtinë me sipërfaqe prej 15m2, me qira mujore prej 307.00 €.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë nga qiramarrësi aktual "Art Motion SH.P.K" tek "Bluechip International L.L.C" me emër tregtar "Comodita Home". Kontrata e qirasë e cila është subjekt transferimi në këtë memorandum është kontrata e lidhur më datë 15/03/2022, me nr. protokolli 39881/2022, dhe objekt i kësaj kontrate të qiradhënies është aseti pronë e "NewCo Grand Hotel", Prishtinë PRN173, konkretisht lokali afarist – zyra nr. 2 që gjendet në katin përdhese të Hotelit Grand me sipërfaqe prej 15m2.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se Lidhur me lokalin afarist zyra nr. 2 me datë 29 prill 2024, qiramarrësi Art Motion SH.P.K ka parashtruar kërkesë me nr. prot 24712/2024, me anë të së cilës ka kërkuar që kontratën e qirasë të është nënshkruara në emër të Art Motion SH.P.K të kalojnë në emër të biznesit Bluechip International L.L.C me emër tregtar "Comodita Home". Arsyeja për këtë kërkesë sipas parashtruesit i referohet faktit se pas një vlerësimi të kujdesshëm të situatës që gjendet OE Art Motion dhe për arsye të mos planifikimit të deritanishëm për zgjerim apo lidhjen e hapësirës me pikën shitëse të Art Motion (që gjendet në hotel Grand), kanë arritur në përfundimin se ky transferim do të jetë më e leverdishëm të kalojë tek BlueChip L.L.C dhe në këtë mënyrë do të mund të përmbushet nevoja e rritjes dhe e zgjerimit të aktivitetit të Comodita Home.

Kjo sipërfaqe prej 15 m2 është ngjitur dhe ka qasje aktualisht vetëm prej lokalit që e ka në shfrytëzim me kontratë të qirasë Comodita Home dhe "Art Motion" Sh.P.K. për arsye që nuk e ka ngjitur apo nuk ka qasje të drejtpërdrejtë nga pika e tyre shitëse me këtë sipërfaqe prej 15 dhe "Art Motion" Sh.P.K. për arsye që nuk e ka ngjitur apo nuk ka qasje të drejtpërdrejtë nga pika e tyre shitëse me këtë sipërfaqe prej 15 m2 e ka të pamundur ta shfrytëzojë dhe për këtë arsye kërkon që të bëhet transferimi i kontratës së qirasë tek Comodita Home me të cilën edhe janë pajtuar që ta marrë në shfrytëzim këtë hapësirë siç deklarojnë pa ndonjë kompensim nga ana e Comodita Home.

Bazuar në këtë Marrëveshje, "Art Motion"SH.P.K ka kërkuar nga AKP/AL që Kontrata e qirasë të ndryshojë, respektivisht që në cilësinë e qiramarrësit të nënshkruhet "Blue Chip"L.L.C dhe jo më "Art Motion" SH.P.K.

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

MH

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do te mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm te fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 qershor 2024

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-204/74

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; Nenit 10. 1.7 i Rregullores Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve; Nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 qershor 2024 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për për qiradhënien direkte respektivisht kërkesa e qiramarrësit "Fellini" për qiramarrjen e pronës – bodrumin e lokalit afarist pronë e NSH Duhani PRN091.**

**II. Vlera e qirasë mujore për bodrumin me sipërfaqe prej 408m2 e përcaktuar nga Komisioni për vlerësimin e qirasë mujore, do të jetë në vlerë prej 3,366.00€ bruto/muaj.**

**III. Miratohet propozimi i AL-së dhe kërkesa e qiramarrësit të loalit afarist pastiqeria DPH "Fellini" me pronar Nebahate Zekaj Ukiq B.I. për ndryshimin e emrit të qiramarrësit dhe Kontratat e qirasë për të dy hapësirat – për lokalin afarist – përdhese me sipërfaqe prej 140m2 si dhe për bodrumin me sipërfaqe prej 408m2, të kalojnë dhe/ose nënshkruhen me qiramarrës Caffetteria "Fellini" shpk me pronarët Nebahate Zekaj Ukiq dhe Patrik Ukiq.**

**IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

**ARSYETIM**

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se Lokali afarist me sipërfaqe prej 140m2 është lëshuar me qira dhe shfrytëzohet nga D.P.H. Pastiqeria "Fellini - 3 - Sweet & Cool" respektivisht biznes individual në emër të Nebahate Zekaj Ukiq B.I. me qira mujore në vlerë prej 2,237.93€/muaj. Qiramarrësi është pagues i rregullt i qirasë. Pjesë e këtij lokali afarist është edhe bodrumi i cili nuk është lëshuar me qira, i pashfrytëzueshëm dhe i cili ka nevojë për renovime për tu shfrytëzuar. Lidhur me bodrumin në fjalë, me datë 29/05/2024 jemi njoftuar se ka pasur tentativa për uzurpimin e kësaj hapësire përmes hapjes së një dere nga pjesa e jashtme nga persona tjerë.

Njëkohësisht, marrë parasysh rrezikun e veprimeve të njëanshme nga personat e tretë për të uzurpuar këtë hapësirë, nëpërmjet kësaj shkrese, qiramarrësi Pastiqeria "Fellini" ka kërkuar që të marrë me qira edhe bodrumin. Zyrtarët gjegjës kanë dalë në vendngjarje dhe kanë konstatuar se në pjesën e jashtme të objektit nga pjesa e bodrumit është hapur një derë për të mundësuar qasjen direkte në bodrum. Në derë është vënë njoftimi se prona administrohet nga AKP-ja dhe e njëjta është mbyllur me dry. Gjithashtu, duhet të kihet parasysh që hyrja e vetme tek pjesa e Bodrumit është përmes lokalit që shfrytëzohet nga ana e Fellinit përmes kontratës së qirasë.

Gjithashtu, qiramarrësi Pastiqeria DPH "Fellini" me datë 02.05.2024 ka bërë edhe një kërkesë që t'i aprovohet ndryshimi i emrit të firmës në kontratën e qirasë nga Pastiqeria Fellini në Caffetteria "Fellini". Pronar i pastiqeria DPH "Fellini" është Nebahate Zekaj Ukiq ndërsa tek Caffetteria "Fellini" sh.p.k. poashtu pronare është Nebahate Zekaj Ukiq respektivisht bashkëpronare me djalin e saj Patrik Ukiq.

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

MH

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do te mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm te fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha. Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 qershor 2024

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-204/75

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; Nenit 10. 1.5 te Rregullores Nr. Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve; Nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Nenet 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 qershor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të ngastrave kadastrale 434-0; 437-0; 438-0 dhe 440-0 ZK Hereç me sipërfaqe të përgjithshme prej 3 ha 75 ari e 12 m2, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 326.35 € për një vit për parashtruesin e kërkesës Xhavit Alija pr pronën e NSh "Ereniku Prodhimtaria Primare" PEJ029.**

II. **Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive, duke e llogaritur nga viti 2019 - 2023, palës Xhavit Alija do i kërkohet të paguajë retroaktivisht shumën prej 1,631.75 € para nënshkrimit të kontratës së qirasë.**

I. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se zyrtarët e AKP-së në fillimin e vitit 2020 kanë vërejtur që kjo pronë është duke u shfrytëzuar për të mbjella bujqësore dhe më pastaj kanë identifikuar edhe shfrytëzuesin. Palës i është kërkuar disa herë nga Autortiteti i Likuidimit që të bëjë lirimin e pronës, por i njëjti ka refuzuar duke pretenduar pronësinë mbi parcelat objekt i kësaj kërkesë.
Më datë 06 maj 2016 në bazë të dokumenteve që posedojmë, pala Xhavit Alija ka parashtruar padi për vërtetimin e pronësisë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Ajo që vërehet është se pretendon pronësinë për sipërfaqen prej 2.30.00 ha, ndërsa sipërfaqja që e shfrytëzon aktualisht është më e madhe se kjo sipërfaqe.
Duke qenë se pala nuk ju ishte përgjigjur pozitivisht ftesave të Autoritetit të Likuidimit për lirimin e pronës dhe kthimin në gjendjen e mëmparshme të parcelave në fjalë, atëherë Autoriteti i Likuidimit është detyruar të parashtrojë padi pranë Gjykatës Themelore Gjakovë për lirimin e pronës dhe kthimin në gjendjen e mëmparshme më datë 10.03.2021. Gjykata Themelore Gjakovë më datë 04.06.2021 ka nxjerrë Aktvendim përmes të cilit është shpallur inkompetente dhe lëndën i ka deleguar Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme.
Për më tepër, Autoriteti i Likuidimit duke parë që parcela kohë pas kohe punohej atëherë është kërkuar lirimi i parcelës dhe më datë 12/09/2022 është bërë lirimi i parcelës dhe janë vendosur shiritat nën praninë e Policisë së Kosovës. Gjithashtu, më datë 18.11.2022 agjencia i është drejtuar Policisë së Kosovës për nisjen e hetimit për shfrytëzimin e parcelave 434-0; 437-0; 438-0 dhe 440-0 ZK Hereç nga ana e Xhavit Alija dhe nuk ka pranuar ndonjë informatë në lidhje me rrjedhën e hetimeve dhe procedurën e ndjekur. Edhe pas këtyre veprimeve të ndërmarra, këtë vit është vërejtur prapë se në parcelat e lartpërmendur ka të mbjella përsëri nga shfrytëzuesi Xhavit Alija dhe përsëri është inicuar procedura e lirimit me Polici më datë 03.06.2024.



M-H

Pas lirimit të parcelës më datë 03.06.2024, pala ka parashtruar kërkesë për qiradhënie direkte dhe në kërkesë ka deklaruar që pronën e shfrytëzon nga viti 2000 sepse e konsideron veten pronar dhe pret që të zgjidhet edhe çështja gjyqësore e ngritur në Gjykatë.

Pasi që pretendimi pronësor i palës është në procedim pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supremede sipas vlerësimit të AL-së, qiradhënia direkte do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm te fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 qershor 2024

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vendimi me numër të referencës: **BD-204/76**

**Vërejtje:**

Ky Vendim nuk është publikuar për shkak se ka të bëjë me çështje të brendshme, qoftë organizative apo procedurale të Agjencisë dhe përmban informacione të individëve të caktuar që mund të bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03/L-172).

Agjencia ju njofton se në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (L-03/L-215), palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë specifike me arsyetim përkatës për qasje në këto Vendime tek Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-204/77

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; Nenit 10. 1.5 Rregullores Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve; Nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 qershor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi për aprovim/korrigjim të vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. BD-175/16 të datës 27.01.2023 në raport me çmimin vlerësues për njësinë nr. 67, e cila nga çmimi sa kishte në 450.00 Euro/muaj të rritet në çmimin prej 767.62 Euro/muaj.**

II. **Obligohet pala që para nënshkrimit të vazhdimit të kontratës së qirasë të paguajë për periudhën janar 2023 – qershor 2024 shumën e qirasë prej 767.62 Euro/muaj. Në rast se pala nuk e paguan çmimin e lartë cekur atëherë do të jetë e obliguar të lirojë asetin dhe të kompensojë Autoritetin e Likuidimit të NSh "Prizren Trans" për periudhën e lartë çekur.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit përmes tw cilit kërkohet ndryshimi i vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. BD-175/16 të datës 27.01.2023, saktësisht korrigjimi vendimit kërkohet të bëhet vetëm në raport me çmimin vlerësues për njësinë nr. 67, e cila nga çmimi sa kishte në 450.00 Euro/muaj ishte rritur në shumën prej 3,029.40 Euro/muaj.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se shfrytëzuesi aktual, i cili shfrytëzonte objektet pronë e NSh Prizren Trans në bazë të aneks kontratës OUT-45068/21, pas njoftimit të datës 20.02.2023 për rritjen e çmimit të qirasë nuk kishte pranuar të nënshkruajë kontratën e qirasë më çmimin e rritur prej 3,029.40 Euro/muaj. I njëjti kishte dërguar disa ankesa në AKP, ku kishte kërkuar që të mos ngarkohet me çmimin e rritur dhe të rishqyrtohet çmimi i rritur i qirasë. Më vonë i njëjti, ka deklaruar që i shfrytëzon vetëm objektet që janë të ndërtuara në parcelën P-9021-2 e cila është pronë e Ekonomia Pyjore Prizren. Pas informatave të tilla, poashtu edhe ZR Prizren ka konfirmuar që parcela në fjalë është në pronësi të Ekonomia Pyjore Prizren. Komisioni gjatë rivlerësimit kishte marrë parasysh në procesin e rivlerësimit të çmimit të qirasë, objektet dhe parcelën në pronësi të NSh Ekonomia Pyjore Prizren dhe prandaj çmimi ka dal të jetë 3,029.40 Euro/muaj. Kjo mund të kuptohet edhe nga fakti se në shkresën e datës 20.02.2023 të AL për palën i është thënë që shfrytëzon sipërfaqen totale prej 6032 m2, e cila del të mos jetë e saktë. Pala kishte parashtruar padi për anulimin e vendimit të Bordit dhe propozim për lëshimin e masës së sigurisë, ku me Aktvendimin C-I-23-0015 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme ishte aprovuar kërkesa për lëshimin e masës së sigurisë dhe i ishte ndaluar AKP-së rritja e çmimit të qirasë. Pas kësaj, AKP kishte parashtruar ankesë ndaj aktvendimit të lartpërmendur dhe Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-I-23-0422 të datës 17 gusht 2023 kishte aprovuar ankesën e AKP-së dhe kishte ndryshuar aktvendimin e shkallës së parë C-I-23-0015 dhe kishte refuzuar kërkesën e palës për lëshimin e masës së sigurisë. Edhe në bazë të kontratës së qirasë por edhe pas rishqyrtimit nga ana e ZR Prizren është kuptuar që pala shfrytëzon vetëm dy objekte në sipërfaqe totale prej 642.33 m2.
Me 24.04.2024 pala ka përsëritur kërkesën e tij për rishqyrtim të kërkesës për rritjen e çmimit pas rivlerësimit dhe pas kësaj është vendosur të rishqyrtohet kërkesa dhe që komisioni i njëjtë të rishqyrtojë çmimin e rivlerësuar për njësinë nr. 67 të raportit të paraqitur në mbledhjen e Bordit më 27.01.2023.

Duke qenë se rivlerësimi i çmimit të qirasë ishte bërë duke pasur parasysh edhe tokën e cila nuk ishte në pronësi të NSh-së, atëherë edhe çmimi i rivlerësuar ka dalur të jetë tejet i lartë në raport me çmimin real i cili duhet të



MH

ishte. Sipas vlerësimit të AL-së, qiradhënia direkte do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm te fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 qershor 2024

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-204/78

Në bazë të neneve 9 dhe 15.2.13 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 5 dhe 16 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të ndryshuar me nenin 20 të Ligjit 06/L-023 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 qershor 2024 nxjerr këtë:

# V E N D I M

**I. Të iniciohen procedurat e likuidimit për Ndërmarrjet Shoqërore/Asetet të paraqitura në tabelën e mëposhtme, duke përfshirë edhe miratimin e buxhetit 2 vjeçar të likuidimit të vlerësuar për Ndërmarrjet Shoqërore/Asetet një nga një, ndërsa shpenzimet e buxhetit realizohen në bazë të nenit 16 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndryshuar me nenin 20 të Ligjit nr. 06/L-023 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.**

| Nr. | ID e NSh-së | Emri i NSh-së | Kategoria | Komuna | Regjioni |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | PRN209 | Stacioni i Veterinës - Podujevë | Ndërmarrje Shoqërore | Podujevë | Prishtinë |
| 2 | PRN205 | ATM-PR | Aset | Zagreb | Prishtinë |
| 3 | PRN213 | Ndërmarrja Botuese Veselin Maslesha | Aset | Sarajevë | Prishtinë |

**II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të emëroj Autoritetet e Likuidimit (AL) për secilën Ndërmarrje Shoqërore/Aset nga pika (i) e Vendimit të Bordit (përfshirë çfarëdo zëvendësimi të kohëpaskohshëm);**

**III. Miratohet shitja e të gjitha aseteve "Sipas ligjit dhe akteve nënligjore të AKP-së", të cilat janë të listuara në dokumentet "Përmbledhje për Bord" (Board Brief) për ndërmarrjet/asetet e propozuara për fillim të procedurave të likuidimit;**

**IV. Vendimi për likuidim dhe fillimi i procedurave të likuidimit hyn në fuqi me datë 10 korrik 2024**

## ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe aprovoi sipas procedurave inicimin e procedurave të likuidimit për tre ndërmarrjet/asetet me arsyetimet sikurse në vijim:

i. **<u>PRN209 "Stacioni i Veterinës" - Podujevë</u>** - Bazuar në analizën ligjore të dokumentacionit përkatës, statusi i kësaj Ndërmarrje është shqyrtuar nga Zyra Rajonale e AKP-së, Komisioni për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve/Asetit dhe sipas rekomandimit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 30 janar 2024 ka aprovuar raportin përfundimtar dhe rekomandimin e Komisionit dhe qëndrimi i tyre është se kjo Ndërmarrje bie nën administrimin e AKP-së (KPS/SDR-1541/PRN209), sipas nenit 5.1 të Ligjit nr. 04/L-034. Në certifikatën e pronës së Stacionit të Veterinës në Podujevë konkretisht parcela P-524-1, 524-2 dhe 1012-10 janë në pronësi të Stacioni i Veterinës Podujevë. Në Certifikatën pronësore të datës 10.10.2023 evidentohet ngastra 524-1 dhe 524-2 në pronësi "Pasuri shoqërore Stacioni i Veterinës", ndërsa ngastra 1012-10 ka kaluar në pronësi të komunës së Podujevës. Ngastra kadastrale 1012-10 aktualisht shfrytëzohet nga Komuna e Podujevës-shkolla e ndërtuar. Në ngastrën kadastrale nr. 524-1 është ndërtuar një shtëpi dhe momentalisht nuk e dimë se me çfarë baze meqë pala nuk është përgjigjur, ndërsa në ngastrën 524-2 janë të parkuar autobusët dhe ka indikacione që kjo ngastër është shfrytëzuar nga Stacioni i Autobusëve në Podujevë.

ii. **PRN205 "ATM-PR" - Zagreb** - Bazuar në analizën ligjore të dokumentacionit përkatës, statusi i këtij aseti ka qenë i shqyrtuar nga Zyra Rajonale e AKP-së, Komisioni për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve/Asetit dhe sipas rekomandimit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 29 mars 2024 ka aprovuar raportin përfundimtar dhe rekomandimin e Komisionit dhe qëndrimi i tyre është se i njëjti bie nën administrimin e AKP-së (KPS1539/PRN205), sipas nenit 5.1 të Ligjit nr. 04/L-034. Në bazë të dokumenteve që posedon AKP-ja, Ndërmarrja për automatizimin dhe teknikën e matjeve në industri "ATM-PR" me seli në Zagreb ka pasur Njësi Punuese në Prishtinë dhe përveç lokalit të përshkruar më lartë, nuk kemi informacion nëse ka pasur edhe asete tjera. Ndërsa për lokalin ekziston një dokument (kopje) e kontratës mbi shitblerjen e banesës/lokalit me numër të protokollit 35, të datës 05.06.1991 ku në cilësinë e shitësit evidentohet Ndërmarrja për automatizimin dhe teknikën e matjeve në industri "ATM-PR" me seli në Zagreb dhe në cilësinë e blerësit evidentohet Kostari Gjergji.

iii. **PRN213 Ndërmarrja Botuese "Veselin Maslesha" - Sarajevë** - Bazuar në analizën ligjore të dokumentacionit përkatës, të sistemuar në KPS (SDR) i këtij aseti dhe nenit 5.1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 04/L-034, ky aset bie nën juridiksionin e AKP-së. Statusi i këtij aseti ka qenë i shqyrtuar nga Divizioni i Zyrës Rajonale (DZR) të AKP-së, Komisioni për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve/Aseteve, dhe sipas rekomandimit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 29 mars 2024 ka aprovuar raportin përfundimtar dhe rekomandimin e Komisionit dhe qëndrimi i tyre është se i njëjti bie nën administrimin e AKP-së (KPS1543/PRN213), sipas nenit 5.1 të Ligjit nr. 04/L-034. Ndërmarrja posedon këtë aset: Lokal Afarist me sipërfaqe prej 81.19 $m^2$ i cili gjendet në lagjen Dardania, BL-5, L-E-A, nr.3, Prishtinë. Ekziston "Kontrata mbi Bashkimin e Mjeteve", për ndërtimin e Lokalit afarist në lagjen "Dardania" BL-5 L-E-A, nr.3 në Prishtinë, në mes të Ndërmarrjes Publike Banesore dhe IRO "Veselin Maslesha" - Sarajevë - OOUR Trgovina na Veliko i Malo - Poslovnica Prishtinë (të cilën e përfaqëson Anton Knol), me nr. protokolli 03-2731/1 i datës 31 korrik 1980.

Duke marrë parasysh faktet si më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 qershor 2024.

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO - Agjencia Kosovare e Privatizimit - Prishtinë

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-204/79

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 qershor 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet kërkesa e Autoritetit të Likuidimit shpërndarjen e përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Theranda (në likuidim) PRZ039 nga Rajoni i Prizrenit.**
**II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Theranda (në likuidim) PRZ039 nga Rajoni i Prizrenit.

Ky vendim u morr duke u bazuar nw faktin se në raportin e shpërndarjes së përkohshme të paraqitur në tetor 2021 e të aprovuar me vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr.Ref. BD-153/3, nuk ishin përfshirë këta kreditor që janë përfshirë në shtojcën 3 të këtij raporti të shpërndarjes, për arsye ne katër kërkesa kreditore kishte ankesa në kohën e paraqitjes së raportit dhe për atë arsye nuk janë paraqitur, për arsye se ankesa e pezullon ekzekutimin e vendimit, ndërsa në dy raste të tjera, siç paraqitet në shtojcën 10 të këtij raporti janë raste me aktgjykime përfundimtare nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të cilët janë në favor të kreditorëve.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe poashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme plotësues të fondeve të Likuidimit të NSh Theranda (në likuidim) PRZ039.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 qershor 2024.

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-204/80

